



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 7351/4840/835 (31026-01038-86-2015) Regjistri
Datë 03.03.2015 regjistrimi

Nr.429 Vendimi
Datë 08.02.2017

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga gjyqtarët:

Kryesues: Arjan Qafa
Anëtare: Alkelina Gazidedja
Anëtare: Enkelejda Metaliaj(Softa)

-asistuar nga sekretare gjyqësore [REDACTED] në Tiranë në datë 08.02.2017 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen administrative me Nr. 7351/4840/835 (31026-01038-86-2015) Regjistri, datë 03.03.2015 regjistrimi, me palë ndërgjyqëse:

PADITËS: Spitali Rajonal Vlorë, Lagja Partizani, Vlorë.
PADITUR: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminim .
Tiranë, Rruga Sami Frashëri, nr.10.
OBJEKTI: Anullim i vendimit nr. 56, dt. 17.04.2014, të Komisionerit për Mbrojtjen Kundër diskriminimit.
BAZA LIGJORE: Neni 154 i K.Pr.Civile. Ligji nr.10221/2010, pikat 15, 16.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin Nr. 5122, datë 25.09.2017, ka vendosur:

*Pranimin e kërkesë padisë së paditësit Spitali Rajonal Vlorë.
Anullimin e vendimit nr. 56, dt. 17.04.2014, të Komisionerit Kundër Diskriminimit.
Shpenzimet gjyqësore sic janë bërë.*

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar që nga e nesërmja shpalljes së këtij vendimi. Për palën e paditur Komisioneri Kundër Diskriminimit dhe av.Shtetit në mungesë afati fillon nga njoftimi i vendimit.

kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur ankim pala e paditur, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesë padisë, duke parashtruar këto pretendime:

- Pala paditëse, në padinë e paraqitur nuk ka përcaktuar saktë objektin e kërkesë padisë dhe nuk ka treguar të drejtën mbi të cilën mbështetet kërkesëpadinë e saj, kërkesa këto të nenit 154 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 17 të Ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.
- Vendimi i nr. 56 datë 17.04.2014, është plotësisht i ligjshëm, pasi ai është marrë në përputhje të plotë me parashikimet dhe procedurën e parashikuar për nxjerrjen e tij. Nuk ka asnjë element që çënon ligjshmërinë duke shkaktuar pavlefshmërinë e tij, qoftë pavlefshmërinë absolute qoftë atë relative. Rastet e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ parashikohen nga neni 116 i Kodit të Procedurave Administrative dhe në referim të tij, rezulton se: i) nuk ndodhemi në kushtet e gërmës “a” të nenit 116, pasi Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk është një organ i pidentifikuar. Komisioneri është një institucion i cili është krijuar dhe funksionon në bazë të parashikimeve të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”; ii) nuk ndodhemi në kushtet e gërmës “b” të nenit 116, pasi akti është nxjerrë plotësisht në përputhje me kompetencat e nenit 32, germa “a” të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010; iii) nuk ndodhemi në kushtet e gërmës “c”. të nenit 116 , pasi akti është nxjerrë në përputhje me procedurën e parashikuar nga neni 33 i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- Në bazë të nenit 118, të Kodit të Pr.Administrative, akti administrativ është relativisht i pavlefshëm nëse ai është nxjerrë në kundërshtim me ligjin, por megjithatë nuk është absolutisht i pavlefshëm. Vendimi nr. 56 datë 17.04.2014, nuk është në kundërshtim me përmbajtjen dhe qëllimin e ligjit dhe nuk është nxjerrë nën ndikimin e lajthimit, mashtrimit, kanosjes apo dhunës fizike, elementë këto që do të shkaktonin pavlefshmërinë relative të këtij vendimi.

- Vendimi nr.98 datë 09.10.2013, i cili ka konstatuar diskriminimin e ankueses dhe është urdhëruar rikthimi i saj në vendin e punës, është një akt i cili nuk është kundërshtuar gjyqësisht nga ana e palës paditëse.
- Pala paditëse me shkresën nr. 2838 prot datë 01.11.2013 me anë të së cilës njoftoi Komisionerin se nuk mund ta zbatojë vendimin për rikthimin në punë të ankueses, e konsideron si pengesë urdhrin nr. 506 datë 18.09.2013 të Ministrit të Shëndetësisë “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna, të punonjësve dhe dhënien me qira të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore”, ndërkohë që nuk ka qënë aspak pengesë për atë, zgjidhja e kontratës së punës me znj. [REDAKTUAR] edhe pse në bazë të një urdhri tjetër të Ministrit të Shëndetësisë nr. 306 datë 04.07.2012 “Për personelin mjekësor infermier që nuk ka plotësuar arsimin e lartë”, ndalohej largimi nga puna i personelit mjekësor dhe laborant që punon në institucionet publike, i cili nuk kishte arsimin e lartë.
- Me shkresën nr. 1779 prot datë 23.04.2014 Spitali Rajonal Vlorë ka njoftuar zj. [REDAKTUAR] se vendi i laborantes në laboratorin bio-kimik në poliklinikë është plotësuar. Urdhri nr. 506 datë 18.09.2013 i Ministrit të Shëndetësisë “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna, të punonjësve dhe dhënien me qira të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore”, të cilit i është referuar pala paditëse për të mos zbatuar vendimin e Komisionerit, nuk e ka penguar atë që të marrë në punë personel të ri.
- Gjykata nuk ka marrë aspak në konsideratë kur ka vlerësuar pamundësinë e palës paditëse se në bazë të një urdhrit tjetër të Ministrit të Shëndetësisë nr. 306 datë 04.07.2012 “Për personelin mjekësor infermier që nuk ka plotësuar arsimin e lartë”, që është një urdhër i mëponshëm dhe ka dalë para se [REDAKTUAR] të largohej nga puna [REDAKTUAR] është larguar në datë 07.05.2013 kur urdhri 306 ka qënë në fuqi), se ndalohej largimi nga puna i personelit mjekësor dhe laborant që punon në institucionet publike, i cili nuk kishte arsimin e lartë.
- Arsyetimi i Gjykatës është plotësisht i pabazuar dhe në asnjë mënyrë nuk justifikon sjelljen e palës paditëse.
- Zbatimi i vendimit të Komisionerit për rikthimin në punë të znj. [REDAKTUAR] nuk vjen në kundërshtim me vendimin nr. 2264 datë 24.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, siç është pretenduar nga pala paditëse, apo siç arsyeton edhe gjykata në vendim.
- Me vendimin nr. 2264 datë 24.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nuk rezulton që kjo gjykatë të ketë shqyrtuar pretendimin për diskriminim të paditëses, e në

përfundim të ketë vendosur për rrëzimin e kërkesës së saj për rikthim në vendin e punës, pasi nuk kemi diskriminim dhe shkelje të parimit të barazisë. Pra nuk kemi të bëjmë me një çështje të gjykuar më parë dhe për të cilën ka një vendim të formës së prerë.

- Në bazë të nenit 37, pika 3, të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", përcaktohet se : *"Vendosja e masave, sipas këtij ligji, nuk përjashton vendosjen e masave sipas ligjeve të tjera."* Në fushën e punësimit, pavarësisht shqyrtimit gjyqësor të mosmarrëveshjeve të punës dhe vendosjes së dëmshpërblimeve sipas parashikimeve të Kodit të Punës, vendosen masat dhe dëmshpërblimet sipas ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Ky ligj në nenin 38 të tij ka përcaktuar se pjesë e dëmshpërbimit për shkelje të këtij ligji dhe konsumimit të diskriminimit ndër të tjera është edhe ndreqja e shkeljeve ligjore dhe e pasojave të tyre përmes kthimit në gjendjen e mëparshme.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

ë dhomë këshillimi. pasi dëgjo i relativimin e çështjes nga gjyqtari Arjan Qafa, shqyrtoi të gjitha ktet shkresore dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

se pranë Gjykatës Administrative të Apelit ka ardhur për gjykim çështja administrative me palë dhe objekt të sipërcituar nga Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në bazë të ankimit të bërë nga pala e paditur.

nga shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumentave, kolegji i Gjykatës Administrative të Apelit çmon se vendimi nr. 5122, datë 25.09.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është i drejtë dhe si i tillë, në referim të dispozitave të nenit 45 dhe 50/a të ligjit nr. 49/2012. duhet të vendoset mospranim i ankimit. Vendimi objekt ankimi është rrjedhojë e analizës së drejtë të provave dhe zbatimit korrekt të ligjit, për rrjedhojë shkaqet e rritura në ankim nga pala e paditur për ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesë padisë, nuk ëndrojnë.

Kolegji, ndryshe nga sa pretendon pala paditëse në ankim, konkludon se gjykata në vendimin e saj objekt shqyrtimi në apel administrativ, i ka dhënë përgjigje gjithë kërkimeve dhe prapësimeve të palëve në proces.

I. Rrethanat e çështjes:

Nga provat e administruara ka rezultuar se, ndaj palës paditëse Spitali Rajonal Vlorë me vendimin nr. 56, dt.17.04.2014, është marrë masa administrative dënim me gjobë nga ana e palës së paditur.

Kjo masë administrative është vendosur pasi, Spitali Rajonal Vlorë ka pasur një konflikt gjyqësor me shtetasen [REDAKTUAR] mbi zgjidhjen e marrëdhënies së punës. Në përfundim të gjyqimit përmes vendimit nr. 2264, dt. 24.10.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë është pranuar pjesërisht kërkesëpadinë e shtetasës [REDAKTUAR] duke i akorduar asaj dëmshpërblim për zgjidhje të marrëdhënies së punës dhe duke rrëzuar kërkimin për rikthim në punën e mëparëshme. Ky vendim ka marrë formë të prerë. Pas zgjidhjes së çështjes nga gjykata paditësja [REDAKTUAR] i është drejtuar me një kërkesë Komisionerit kundër Diskriminimit, nëpërmjet së cilës kërkon marrjen e masave përkatëse. Nga ana e komisionerit është filluar procedimi administrativ lidhur me këtë çështje.

Pala e paditur, Komisioneri në përfundim të këtij procesi ka dalë me vendimin nr. 98, dt. 09.10.2013, sipas të cilit i ka rekomanduar palës paditëse në këtë proces, Spitalit Rajonal Vlorë rikthimin e paditëses në detyrën e mëparëshme.

Nga ana e Spitalit Rajonal, nëpërmjet shkresës nr. 1338, datë 21.03.2014, i është dhënë përgjigje Komisionerit, se cilat janë arsyet se, përse e nëjnë të pamundur përmbushjen e rekomandimit.

Në këto rrethana, Komisioneri, në mungesë të zbatimit të rekomandimit për rikthimin e shtetasës [REDAKTUAR] në detyrën e mëparëshme ka dalë me vendimin nr. 56, datë 17.04.2014, sipas së cilës është marrë masa administrative dënim me gjobë në masën 60 000 lekë gjobë, ndaj subjektit Spitali Rajonal Vlorë.

Sa më sipër, pala paditëse, duke mos qënë dakord me këtë masë administrative, i është drejtuar gjykatës me kërkesë padinë objekt gjykimi.

II. Vendimi dhe arsyetimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë:

Në analizë të pretendimeve të parashtruara në kërkesë padi, të provave e akteve shkresore të administruara dhe rrethanave të faktit e të ligjit, Gjykata ka vlerësuar se, padia e paraqitur për gjykatës është e bazuar në prova dhe në ligj, ndaj ka disponuar me pranimin e saj, duke arsyetuar se,

së pari; Paditësi Spitali rajonal Vlorë ka qënë në pamundësi të përmbushjes së rekomandimit të lënë nga ana e Komisionerit kundër Diskriminimit. Konkretisht në pozicionin e mëparëshëm të paditëses është emëruar një person tjetër, me arësim të lartë profesional. Nga tjetër shtetasja [redacted] nuk ka plotësuar kriterin arësimor për të qënë pjesë e strukturës profesionale të Spitalit Vlorë. Referuar urdhërit të Ministrit të shëndetësisë nr. 176, dt. 02.04.2010, nuk lejohet asnjë mërim infermier pa arësim të lartë, ndërkohë që edhe atyre ekzistues u është lënë një afat dy jehar deri në fund vitin 2012 për të marrë masa për të përfunduar arësimin e lartë. Rekomandimi i Komisionerit daton pas daljes së urdhërit të M.Shëndetësisë dhe pas kalimit të afatit limit viti 2012. Pra pala penalizuar spitali Vlorë nuk ka rrefuzuar me dashje në formë kundërvënies zbatimin e rekomandimit të Komisionerit, por praktikisht ka qënë në pamundësi të plotësimit të tij për arësyet e mësipërme të cilat i janë bërë me dije edhe komisionerit.

së dyti; çështja e rikthimit të shtetasës [redacted] në detyrën e mëparëshme ka qënë objekt edhe i një gjykimi, në përfundim të të cilit me vendim i cili tashmë është i formës së prerë, është refuzuar kërkitimi për rikthim të paditëses në detyrë. Nuk mundet që një çështje e gjykuar të rigjykohet nga aparati administrativ i cdo niveli apo hierarkie. Argumenti i përdorur nga ana e komisionerit sipas të cilit gjykata nuk ka gjykuar mbi ekzeitencën apo jo të diskriminimit nuk lëndron pasi gjykata është shprehur mbi atë çfarë është më kryesorja, mbi zgjidhjen e pasojave të mosmarrëveshjes, kur ka rrëzuar kërkitimin për rikthim në detyrë.

Nga sa më lart gjykata arrin në përfundimin se pala paditëse ka qënë në pamundësi objektive për të përmbushur rekomandimet e komisionerit kundër diskriminimit, e për pasojë nuk mund të rigjykohet me përgjegjësi civile dhe administrative.”

II. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

së pari gjykata vlerëson të evidentojë kompetencën e saj për shqyrtimin e ankimit objekt i këtij gjykimi. Në referim të nenit 7 gërma “a”, nenit 10 paragrafi 2 gërma ”a” dhe nenit 44 të Ligjit nr. 49/2012, kjo gjykatë ka kompetencën lëndore dhe funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje.

së dyti në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së ankimit, Gjykata Administrative e Apelit konstaton se ankimi nuk është paraqitur konform kërkesave ligjore të neneve 44, 45 dhe 46 të Ligjit nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin të Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe për këtë arsye duhet vendosur mospranimi i tij për shqyrtim për këto arsye:

Në nenin 45 të ligjit nr. 49/2012 përcaktohet se:

"Nuk lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt

a) kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

b) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

c) kundërshtimin e aktit administrativ që ka refuzuar dhënien e detyrimit në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

ç) mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa afësisë së kufizuar, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi".

Siç rezulton nga përmbajtja e kësaj dispozite, ligji nuk lejon ankim ndaj vendimeve të cilat kanë zgjidhur mosmarrëveshje administrative në lidhje me akte administrative që përmbajnë vlera më të ulëta se 20-fishi i pagës minimale. Me VKM-në nr. 573, datë 03.07.2013 "Për caktimin e pagës minimale në shkallë vendi" është vendosur që prej datës 1 korrik 2013 se: "Paga bazë minimale mujore për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 22 000 (njëzet e dy mijë) lekë".

Në rastin konkret, objekt kundërshtimi në gjykatë është masa administrative e vendosur nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimit ndaj palës paditëse Spitali Rajonal Vlorë, me arsyetimin se nuk ka zbatuar rekomandimet e tij në lidhje me rikthimin në vendin e mëparshëm të punës së shtetasës [REDAKTUAR]. Me vendimin nr. 56, datë 17.04.2014, nga pala e paditur është marrë masa administrative dënim me gjobë në masën 60 000 lekë gjobë, ndaj subjektit Spitali Rajonal Vlorë.

Duke qenë se shuma e përcaktuar në aktin administrativ objekt kundërshtimi është më e vogël se 20-fishi i pagës minimale të përcaktuar me VKM-në e mësipërme, Vendimi nr. 5122, datë 25.09.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është vendim i paankimueshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative".

Në nenin 50/a të ligjit nr. 49/2012 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative" parashikohet se: "Gjykata administrative në dhomë këshillimi vendos:

) Mospranimin e ankimit, në rastet kur ankimi nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë dhe Gjykata administrative e shkallës së parë nuk e ka bërë një gjë të tillë".

Në këto kushte Gjykata Administrative e Apelit çmon se ndodhet në kushtet e nenit 45 në lidhje me nenin 50/a të ligjit nr. 49/2012 dhe duhet të vendosë mospranimin e ankimit për shkak se nuk lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt:

Kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzet-fishi i pagës minimale, në shkallë vendi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenet 49 e 50, gërma "a" të ligjit nr. 49/2012 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative".

VENDOSI

Mospranimin e ankimit të palës së paditur Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi kundër vendimit nr. 5122, datë 25.09.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë Tiranë.

I shpall në Tiranë sot më datë 08.02.2017.

ANËTARE

Enkelejda METALIAJ (SOFTA)

d.v

ANËTARE

Alkelina GAZIDEDJA

d.v

Vertetohet njesia me origjinalin

KRYESUES

Arjan QAFA

d.v

*Kancelari
Leonard Steadof
Bucuraj*